



V E N D I M

K.P.P. 721/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-74945-06-14-2018, me objekt: “Shërbimi i Ruajtjes së Sigurisë Fizike për abjentet nën administrimin e Ujësjetllës Kanalizimeve Mat”, me fond limit 18,374,295 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.07.2018 nga autoriteti kontraktor, SHA Ujësjetllës Kanalizime Mat

Ankimues:

“Safe” sh.p.k.
Adresa: Njësia Bashkiake Nr. II, Rruga “Bernard Bilota Kulla
“Haëai- Toëer”, Nr 17, Pazar 2 Katil, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

SHA Ujësjetllës Kanalizime Mat
Adresa: Lagja ‘Partizani’ Rruga “Ibrahim Temo” Burrel Mat.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për

Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.06.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-74945-06-14-2018, me objekt: “*Shërbimi i Ruajtjes së Sigurisë Fizike për abjentet nën administrimin e Ujësjellës Kanalizimeve Mat*”, me fond limit 18,374,295 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.07.2018 nga autoriteti kontraktor, SHA Ujësjellës Kanalizime Mat

II.2. Në datë 19.07.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se më datën 01.08.2018 autoriteti kontraktor ka bërë vlerësimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve, si më poshtë vijon:

1. “Kurti Security” shpk	17,491,987.44	lekë	skualifikuar
2. “Safe” shpk	17,497,956.27	lekë	skualifikuar
3. “Grand Security” shpk	17,498,056.48	lekë	kualifikuar
4. “ISA” shpk	17,498,056.48	lekë	kualifikuar

5. "Res-03." sh.p.k.	17,498,056.48 lekë	kualifikuar
6. "Trezhnjeva" shpk	17,498,056.48 lekë	kualifikuar
7. "Eurogjici Security" shpk	17,498,056.48 lekë	kualifikuar
8. "Snajper Security" shpk	17,498,056.48 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 01.08.2018, operatori ekonomik "Safe" sh.p.k. është njoftuar për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

1. Kriteret e vecanta te kualifikimit pika 1/c (formulari i ofertes pika, sipas shtojces 1, dhe Kapaciteti teknik pika 8. Operatoret ekonomik duhet te paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur(shih shtojca 1 sqarime), nuk i eshte permbajtur analizes se kostos:

2. Dokumenti Vendim nr. 171/4 date 31.12.2005 i Drejtorise se Policise se Shtetit nuk eshte ne formen e duhur te kerkuar nga ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar neni 13 pika 3/a si dhe neni 45 paragrafi 2 shkroinja e).

II.4.1. Në datën 04.08.2018 operatori ekonomik "Safe" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, me argumentat në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

[.....]

Sh.p.s.f SAFE sh.p.k mori dijeni ne faqen zyrtare të Agjencise të Prokurimit Publik ëëë.app.gov.al me njoftimin e renditjes se operatoreve ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit publik me objekt Sherbim i ruajtjes se sigurise fizike per ambjentet nen administrimin e Ujesjelles Kanalizimeve Mat SH.A, e organizuar nga Autoriteti Kontraktor Ujesjelles Mat sh.a zhvilluar ne date 19.07.2018. Ne zbatim të nenit 63 "Te drejtat e personit to interesuar" pika 2 të LPP "po ju dergojme kete ankese duke ju sqaruar si vijon :

KVO-ja e ngritur nga A.K Ujesjelles Mat sh.a per vleresimin e operatoreve ne kete procedure ka publikuar ne daten 01.08.2018 renditjen si me poshte: [...]

Vleresimet per tenderin "Sherbim i Ruajtjes se Sigurise Fizike per Ambjentet nen administrimin e Ujesjelles Kanalizimeve Mat" (Faza e vleresimit të tenderit)[...]

Po ne daten 01.08.2018 KVO-ja dergon nje mesazh elektronik ku jep ajo shprehet se:

1. Kriteret e vecanta to kualifikimit pika i/c (formulari i ofertes pika,sipas shtojces 1, dhe Kapaciteti teknik pika 8. Operatoret ekonomik duhet të paraqesin analizen e kostos per oferten e paraqitur(shih shtojca 1 sqarime), nuk i eshte permbajtur analizes se kostos:

2. Dokumenti Vendim nr. 171/4 date 31.12.2005 1 Drejtorise se Policise se Shtetit nuk eshte ne formen e duhur to kerkuar nga light nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 13 pika 3/a si dhe neni 45 paragrafi 2 shkroinja e).

c) Per sa i perket arsyes se pare të skualifikimit kemi sqaruar A.K dhe me heret ne nje kerkese qe na ka derguar elektronikisht ne daten 25.07.2018 ku kerkonte korrigjimin e ofertes sone me arsyetimin se kemi bere gabime aritmetike ne perlllogaritje.

Ky konstatim i bere nga ana juaj si ne daten 25.07.2018 por edhe tani ne renditjen e dates 01.08.2018 ne të cilen ju keni vendosur skualifikimin e shoqerise tone nuk eshte i bazuar ne fakte konkrete per kete po ju argumentojme si me poshte:

-Duke iu referuar DST-se të publikuar nga ana juaj perkatesisht formulari i ofertes shtojca 1 dhe Sqarimeve bashkangjitur ketij formulari ju rikujtojme se keni kerkuar: referojmë [...]formularin e ofertes shtojca 1 [...]

Pra ketu kerkohet qe ofertat të bazohen ne koston ditore të kryerjes se sherbimit. Per hir të se vertetes ne kthimin e pergjigjes se dates 26.07.2018 i kemi sqaruar Autoriteti Kontraktor se ne gjykimin tone referuar fakteve të mesiperme A.K ne kundërshtim me të gjitha rregullat e prokurimit publik ne shtojcen 1 formulari i ofertes kerkon nje oferte mujore dhe totale të sherbimit ndersa ne preventivat me poshte kerkon ate ditore të kryerjes se sherbimit. Ne daten 01.08.2018 pas marrjes se njoftimit të klasifikimit të O.E jemi akoma me të bindur se keto veprime Jane të qellimshme per cuar ne konfuzion operatorët gjate hartimit të ofertave dhe me keq akoma per deshtimin e kesaj procedure.

3.Duke vijuar arsyetimin per to zbatuar keto kritere të vendosura nga AK ne DST kemi hartuar oferten tone me preventivat perkates si ato bazuar ne koston mujore të sherbimit por dhe ne ato ditore të cilat totalisht të barabarta ne kosto dhe ne ndryshim të asaj qe pretendoni ju respektojne të gjithë detyrimet ligjore ne fuqi. Per kete po japim nje shemull të thjeshte ju thoni se ne kemi llogaritur per pagën baze ditore per vitet me 365 vite ne vlerën 1.183,82leke nderkohe qe sipas jush duhej të perlllogaritnim 1182.48 leke. Pra vlera e ofertuar nga ana jone eshte me e larte se ajo e supozuar nga ju. Natyrshem na lind e drejta tju pyesim cila nga keto vlera nuk respekton VKM nr 399 date 03.05.2017 Per percaktimin e pages baze minimale dhe Ligjin 75/2014 "Per sherbimin privat to sigurise fizike" neni 18 ?

Ne gjykimin tone vlera e ofertuar nga ana jone eshte ligjore per sa kohe eshte me e larte se ajo e supozuar nga ana juaj. Duke vazhduar me tej ju sqarojme se

Duke iu referuar Iegjislacionit ne fuqi dhe rekomandimit të fundit të APP dhe KPP kemi:

Ne rast se viti kalendarik do to kete 365 vite shtesat dhe veshtiresite do to perlllogariten me 365 dite / 12 muaj = 30.41 dite muaji , ndersa ne rastin konkret brenda afatit të realizimit të kesaj kontrate kemi nje vitin 2020 i cili ka 366 dite kjo e /12 muaj=30.5 vite muaji (per kete arsye edhe ne oferten e dorezuar nga ana jone ndodhen bashkangjitur preventivë perkates te ndare sipas ketyre periudhave si per vitet me 365 dite ashtu dhe perate me 366 dite gjithashtu dhe preventivet me koston ditore të kryerjes se sherbimit dhe keto sipas peridhave perkatese)referojmë pëerlllogritjet e viteve[...]

Per sa iu ilustruam mesiper dhe per të gjitha argumentat ligjore të sipercituara i kerkojme AK të korrigjose shkeljen e kryer nga KVO-ja duke kuaiifikuar Safe sh.p.k.

Kerkesa jone eshte e bazuar dhe ligjore mosmarrja e masave nga ana juaj është katërcipërisht shkelje e të gjitha rregullave të miratura të prokurimit publik dhe ligjeve ne fuqi.

4. Per sa i perket arsyes se dyte të skualifikimit ju citojme:

Dokumenti Vendim nr171/4 date 31. 2.2005 i Drejtorise se Policise se Shtetit nuk eshte ne formen e duhur të kerkuar nga ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar neni 13 pika3/a si dhe neni 45 Paragrafi 2 shkronja e).

-Pike se pari sqarojme se Vendimi i leshuar nga Drejtori i Pergjithshem i Policise se Shtetit nr 171/4 mban daten 31.12.2015 dhe jo 31.12.2005. Se dyti forma e ketij vendim nuk eshte as tager as juridiksion i ligjit të prokurimit publik per kete mund edhe të informoheni pasi llogjikisht jane dy gjera diametralisht të kunderta. Se treti per sa i perket vertetise se ketij vendimi mund ti referoheni License të leshuar nga QKL per subjektin tone ne të cilen ky vendim eshte i cituar pasi kjo license nuk leshohet ne rast se nuk jepet vendimi i Drejtorit të Policise se Shtetit. Gjithashtu per të perforcuar arsyetimin ne rast dyshimi duhej ti permabaheshit L.P.P duke kryer verifikimet perkatese e me pas të kryenit skualifikimin tone. Ne rast të kundert kete argument e keni perdorur thjesht per të gjetur arsye per skualifikimin tone ju kujtojme se ju eshte besuar nje detyre publike të cilen nuk mund të shperdoron duke akuzuar nje taksapagues të rregullt pa patur fakte konkrete. Atehere e drejta per tju akuzuar i lind shoqerise tone per sa kohe keto qe ju shkruani pa menduar jane aludime dhe jo fakte të verteta dhe të bazuara ne dokumenta konkrete të vertetuara nga Institucioni qe ka leshuar kete vendim qe ju e quani "te rreme".

Per sa ju ilustruam me siper dhe per të gjitha argumentat Iigjore të sipercituara i kerkojme AK të korrigjone shkeljen e kryer nga KVO-ja duke kualifikuar Safe sh.p.k.

Kerkesa jone eshte a bazuar dhe Iigjore ndersa argument juaj eshte dashakeqes dhe joligjor ndaj mosmarrja a masave nga ana juaj eshte katerciperisht shkelje a të gjitha rregullave të miratura të prokurimit publik dhe ligjeve ne fuqi.

Per sa me siper dhe ne zbatim të L.P.P ju kerkojme:

Shqyrtimin dhe marrjen parasysh të ankeses tone.

Pezullimin e procedures deri sa ankesa jone të shqyrtohet plotesisht ankesa jone.

Kualifikimin e Safe shpk.

Publikimin e njoftimit të kualifikimit.

II.4.2. Në datën 09.08.2018, me shkresën nr. 809 prot, datë 08.08.2018 operatori ekonomik "Safe" shpk, është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 17.08.2018, pala ankimuese operatori ekonomik "Safe" shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtat pretendime që ka parashtruar dhe tek autoriteti kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 809 prot, datë 08.08.2018, protokolluar me tonën me nr. 1413/2 prot, datë 29.08.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Safe" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "1. Kriteret e vecanta te kualifikimit pika 1/c (formulari i ofertes pika, sipas shtojces 1, dhe Kapaciteti teknik pika 8. Operatorët ekonomik duhet te paraqesin analizen e kosos per oferten e paraqitur(shih shtojca 1 sqarime), nuk i eshte permbajtur analizes se kosos: ", Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 809 prot, datë 08.08.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 1413/2, datë 29.08.2018, si dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se, në datën 26.07.2018 përmes një mesazhi në faqen e APP- së autoriteti kontraktor i është drejtuar operatorit ekonomik “Safe” sh.p.k.pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi me kërkesë për korigjim oferte me përmbajtjen si më poshtë vijon: “[...]Bazuar ne Ligjin nr 9643 date 20.11.2006 “ Per prokurimin Publik “ te ndryshuar , VKM nr 914 date 29.12.2014 “ Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik “ neni 66 , dhe bazuar ne perputhje te me DST –te e hedhur per prokurim pika 3.2.1 ku shprehet Autoriteti Kontraktor korigjon cdo gabime në ofertë, që janë thjesht të një natyre aritmetike, nëse gabimi zbulohet gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti Kontraktor e njofton menjëherë Ofertuesin në fjalë me një njoftim me shkrim/elektronik mbi çdo korigjim të tillë dhe mund të vazhdojë me ndryshimin e gabimit, me kusht që Ofertuesi t’ a ketë miratuar këtë komunikim që i është bërë. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë , Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.Duke u nisur se nga ana e AK eshte konstatuar ne fazen e vleresimit te ofertave nje gabim material ne perlllogaritjen e ofertes tuaj, jeni te lutur qe te beni korigjimin e ofertes suaj pasi nga perlllogaritjet e AK bazuar dhe ne alalizen e kostos tuaj per nje vendroje ne dite rezulton qe ju te keni dhene oferten tuaj me gabime matematike si me poshte: Vlera totale pa tvsh e dhene nga ana juaj ne oferte per nje vendroje ne dite $1604.51 \times 4.98 = 7990.45$ leke ne dite.

Ju bejme me dije se nga ana jone eshte kerkuar analiza e kostos per nje vendroje ne dite me tre turre ku ju ne menyre te Gabuar e keni dhene ne shumen prej 7990.45 ku referuar orjentimeve te dhena nga app per llogaritjen e kostros ne baze te gjith komponenteve vlere reale e nje vendroje me tre turre duhet te ishte 7988.96 leke ne dite. Po ashtu Ju nuk keni llogaritur ne menyre te sakt oferten per 36 muaj pasi nuk keni marre parasysh qe shuma totale e diteve per 36 muaj qe korrepondojne me tre vjet eshte 1096 dhe jo 1095 aq sa e keni llogaritur juve, duke qen se muai shkurt 2020 ka 29 dite pune. Nga analiza e kostos qe ju keni paraqit ne perpjestim me ditet e punes korresponduese oferta juaj duhet te perkoj me shumen prej: Vlera totale pa tvsh per nje vendroje ne dite 7988.96×1096 dite (qe korrespondon me 2 vite $\times 365$ + viti 2020 me 366 = 8.755.900,16 leke $\times 2$ vend roje me tre turre = 17.511.800,32 leke. Ujesjelles Mat sha, me adrese Lgj “Partizani” Rr “Ibrahim Temo” Nr 6 Burrel; ju njofton ne rruge elektronike per pranimin e vleres totale te korigjuar dhe kthimin e pergjigjes nga ana juaj brenda dates: 25.07.2018 , ora 16:00 ne adresen ëëë.app.gov.al seksioni-mesazhe. Nëse Ofertuesi refuzon të pranojë korigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet.”

III.1.2. Në datë 26.06.2018 shoqëria “Safe” shpk i kthen përgjigje Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit, duke mospranuar kërkesën për korigjim oferte me arsyetimin e mëposhtëm: “[...]SH.P.S.F SAFE sh.p.k ne pergjigje te kerkeses tuaj te ardhur ne menyre elektronike me objekt “Kerkese per korigjim oferte”,sqarojme KVO-ne dhe A.K: Oferta jone ekonomike jo vetem qe eshte hartuar ne perputhje me te gjitha dispozitat ligjore te permendura nga ana juaj ne kerkese por edhe shoqerohet me analize te detajura me veprime

matematikore te sakta edhe pse per hir te se vertetes Autoriteti Kontraktor ne kundershtim me te gjitha rregullat e prokurimit publik ne shtojcen 1 formulari i ofertes kerkon nje oferte mujore dhe totale te sherbimit ndersa ne preventivat me poshte kerkon ate ditore te kryerjes se sherbimit qe me pak fjale eshte veprim i qellimshem per cuar ne konfuzion operatorët gjate hartimit te ofertave.

Gjithsesi shoqeria jone ka ofertuar ne baze te gjitha rekomandimeve te APP dhe KPP duke marre parasysh edhe faktin se viti 2020 qe eshte nje vit I brishte me 366 dite dhe duke iu referuar rekomandimeve te APP dhe KPP shtesat per veshtiresite do te llogariten 30.5 dite muaji ndersa per dy vitete e tjera te kontrates me 30.41 dite muaji. Ne nuk shohim se ku rezultojne sipas jush gabime matematikore per sa kohe ne perlllogaritje kemi perdorur dhe jemi bazuar ne legjislacionin te cilin ju e permendi ne kerkesen tuaj ne rast se do te shohim me vemendje ju thoni se nje vendroje ditore ka si vlere shpenzimi 7,982.69 leke ne dite pa tvsh, nderkohe qe vlere ditore per nje vendroje te ofertuar nga ana jone per vitet me 365 dite eshte 7990.59 ndersa per vitin e brishte me 366 dite eshte 7970.28. Edhe po te nxirrnim nje mesatare per te tre vitet e ofertes tone vlere do te ishte 7983.82 leke pra eshte gjithsesi me e larte se ajo kerkuar nga ju ne kete kerkese.

Pra eshte e qarte se oferta jone ekonomike eshte ajo qe permbush te gjitha kerkesat ligjore dhe jo ajo qe u pretendoni.

Gjithashtu kerkojme te rikujtojme KVO-se dhe A.K nenin 55 pika 2 e L.P.P citojme :, “Autoriteti kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”.

Dhe po ti referohemi kerkesave tuaja ne DST ne ikemi plotesuar totalisht keto kerkesa duke paraqitur Formularin e Ofertes preventive perkates dhe analizen e koston duke perfshire si vitin e brishte ashtu dhe dy vitet e tjere edhe pse ky konstatim duhej te ishte nje detyrim i juaji ne momentin e shpalljes se DST duke evituar ne kete menyre konfuzionin.

Theksojme kete fakt pasi ne kerkese shpreheni se ne nuk kemi respektuar rekomandimet e APP dhe KPP, por ne te vertete ndodh e kunderta sic ju shpjeguam me siper keto rekomandime nuk i keni respektuar ju per tju marre nje shembull ju rikujtojme rekomandimin e fundit te APP dhe KPP te dates 23.02.2018 “Mbi nje ndryshim ne Rekomandimin mbi menyren e zhvillimit te procedures te sherbimit te ruajtjes dhe sigurise fizike te dates 20.12.2017” perkatesisht pika 2 .

Si dhe DST standarte te publikuar nga APP pikerisht ne lidhje me kete ndryshim te dyja keto ndryshime kane ndodhur disa muaj para shpalljes se kesaj procedure po cudireshit nuk jane te pasyruara ne DST e kesaj procedure ose me sakte jane perdorur me standarte te dyfishta.

Per sa me lart shoqeria jone gjykon se oferta jone ekonomike eshte ligjore dhe respekton pike per pike te gjithe legjislacionin ne fuqi qe normon sherbimin privat te sigurise fizike dhe nuk shohim ne asnje nga veprimet dhe perlllogaritjet tona gabime matematikore apo mosrespektim te dispozitave te KP te sigurimeve shoqerore apo pages baze minimale mujore.

Nga ana tjeter duke Ju faleminderuar per mirekuptimin shpresojme qe KVO-ja dhe A.K ne punen e tyre ti permbahen kerkesave te ligjeve ne fuqi , DST-se se publikuar si dhe normave ligjore te miratuara te prokurimit publik.[...]

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

* * *

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njësia (Muaj)	Sasia (nr.vendroje ve)	Numri total i rojeve për vendroje	Çmimi Njësi /muaj	Oferta në total (neto)
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se Ujesjeles Kanalizimeve Mat	9.96	(2)	(4.98)	(X)	(X)
	Oferta Neto ne total					
	TVSH (%)					(X)
	Oferta total					(X)

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Sqarime:

1. Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha kostot per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kosos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore.), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.4. Gjithashtu në shtojcën 8, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 8 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

8. Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e kosos per oferten e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)

III.1.5. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.), si dhe vetë konfirmimit të operatorit ekonomik ankimues "Safe" shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

Shtojcën.1 "Formularin e ofertës" të plotësuar, i cili është i shoqëruar me analizën e kosos ditore sipas preventivit të dhënë në këtë shtojcë.

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”*.

III.1.7. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 66, pika 4, përcaktohet se: *“Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:*

- Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar”.

- Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë.

Nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.”.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore, si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore. Shërbimi i kërkuar është për 1 vendroje dhe përkasisht me 4.98 roje, me shërbim Turni I, II dhe III nga e hëna në të djelë për 36 muaj. Gjithashtu, autoriteti kontraktor në kriteret për kualifikim ka përcaktuar që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizën e kostos ditore (preventivin) si pjesë përbërëse e formularit të ofertës.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Safe” shpk, ashtu sikurse ka konstatuar dhe KVO-ja ka gabime aritmetike në zërat e preventivit shtesë mbi pagë për turnin e II, shtesë mbi pagë për turnin e III, shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetsore dhe vlera totale për 1 (një) vendroje në ditë.

Komisioni sqaron se të drejtën që i ka dhënë legjislacioni për prokurimin publik që të pranojë ose jo korrigjimin e gabimeve aritmetike të konstatuara nga KVO-ja, ankimuesi e ka ushtruar, por duke mos e pranuar atë dhe në zbatim të kërkesave të nenit 66, pika 4, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, oferta është refuzuar.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në kushtet kur, operatori ekonomik nuk ka pranuar korrigjimin e ofetës, për shkak të gabimit aritmetikor, i cili ekziston në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor me të drejtë ka refuzuar ofertën e ankimuesit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se *“Nëse pas kërkesës së komisionit të vlerësimit të ofertave,*

ofertuesi refuzon të pranojë korrigjimin e propozuar, atëherë oferta do të refuzohet, pa konfiskim të sigurimit të ofertës, nëse ekziston një e tillë.

Rrjedhimisht, sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Safe” shpk nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues “Safe” sh.p.k., për skualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes tashmë që nuk i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, duke mbetur i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interes e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga “Safe” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-74945-06-14-2018, me objekt: “Shërbimi i Ruajtjes së Sigurisë Fizike për abjentet nën administrimin e Ujësjetës Kanalizimeve Mat”, me fond limit 18,374 ,295 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 19.07.2018 nga autoriteti kontraktor, SHA Ujësjetës Kanalizime Mat.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1413Prot.; Datë 17.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha